



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKTVENDIM

Nr _____ Datë ____/____/2023

MBI MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE TË BASHKISË BERAT SI BORXH I RIMBURSUESHËM PËR PROJEKTIN FIRE PREP

Këshilli Bashkiak Berat në mbledhjen e datës _____._____.2023 , pasi u njoh me materialin “ MBI MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE TË BASHKISË BERAT SI BORXH I RIMBURSUESHËM PËR PROJEKTIN FIRE PREP”, mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 40, pika 1, neni 54 gërma “dh”, neni 64 gërma “c”, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 6, gërma “d”, neni 46, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar , të ligjit nr. 84/2022 “Për Buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 19.01.2023 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022, Vendimin e Këshillit Bashkiak nr 100 datë 22.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025” i ndryshuar; me propozim të Kryetarit të Bashkisë Berat,

V E N D O S I :

1. Miratimin e përdorimit të fondeve të bashkisë Berat në shumën 4,585,812 lekë , si borxh i rimbursueshëm për projektin Fire Prep për të mbuluar shpenzimet që kanë të bëjnë me pagesat finale të rehabilitimit të Stacionit Zjarrfikës Berat, pagesë finale të blerjes se uniformave për zjarrfikësit dhe pagesë finale për supervizim të punimeve. Fondet do të sigurohen si më poshtë :

Shtesa

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Llogaria	Kod Projekti	Pershkrimi	Shuma LEK
2102001		Bashkia Berat (Aparati)				4,585,812
		03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile			4,585,812
2102001	05	03280	231		Projekti "Fire Prep", financim i perkohshem, i rimbursueshem nga donatori	4,585,812
Totali i Shtesave						4,585,812

Pakësime

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Llogaria	Kod Projekti	Pershkrimi	Shuma LEK
2102001		Bashkia Berat (Aparati)				1,722,053
		09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor			1,722,053
2102001	05	09120	231		Fond për pagesën e TVSH për projektin me financim të huaj "Shërbime multifunksionale në sektorin e arsimit", të financuar nga BE nëpërmjet instrumentit BE për bashkitë	1,722,053

2102004	Agjencia e Shërbimeve Publike					2,863,759
		06260	Shërbimet publike vendore			2,863,759
2102004	05	06260	600	9999999	Paga	2,863,759
					Totali i Pakësimeve	4,585,812

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Integritimit Europian dhe Projekteve , Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave .

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ervin CECA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKTVENDIM

Nr _____ Datë ____/____/2023

PËR SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2023 TË BASHKISË BERAT ME FONDIN PËR RRIJTJEN E PAGAVE NË ZBATIM TË VENDIMIT NR. 328, DATË 31.05.2023

Këshilli Bashkiak Berat në mbledhjen e datës _____.____.2023 , pasi u njoh me materialin “Për shtesë në buxhetin e vitit 2023 të bashkisë Berat me fondin për rritjen e pagave në zbatim të Vendimit nr. 328, datë 31.05.2023.”, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 54, gërma “dh”, neni 64 gërma “c”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar , të ligjit nr. 84/2022 “Për Buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit plotësues nr. 2 datë 19.01.2023 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr 100 datë 22.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025” i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.328 datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njërive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar , të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njërive të vetëqeverisjes vendore”, shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 12674 datë 10.07.2023 “Dërgohet akordimi i fondit për rritjen e pagave në zbatim të Vendimit nr. 328, datë 31.05.2023” , me propozim të Kryetarit të Bashkisë Berat,

V E N D O S I :

1. Në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 100 datë 22.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2023 dhe PBA 2023-2025” i ndryshuar , të bëhet shtesa si më poshtë :

Të shtohet buxheti i vitit 2023 me 17,533,008 lekë me fondin për rritjen e pagave në zbatim të Vendimit nr. 328, datë 31.05.2023.

Shtesë :

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Llogaria	Kod Projekti	Pershkrimi	Shuma LEK
2102001	Bashkia Berat (Aparati)					4,522,303
		01110	Planifikim, menaxhim dhe administrim			3,501,000
2102001	01	01110	600	9999999	Paga	3,000,000

2102001	01	01110	601	9999999	Sigurime shoqerore	501,000
		10430	Përkujdesja Sociale			1,021,303
2102001	01	10430	600	9999999	Paga	862,000
2102001	01	10430	601	9999999	Sigurime shoqerore	159,303
2102004	Agjencia e Shërbimeve Publike					5,085,000
		04520	Rrjeti rrugor rural			2,685,000
2102004	01	04520	600	9999999	Paga	2,300,000
2102004	01	04520	601	9999999	Sigurime shoqerore	385,000
		06260	Shërbimet publike vendore			2,400,000
2102004	01	06260	600	9999999	Paga	1,500,000
2102004	01	06260	601	9999999	Sigurime shoqerore	900,000
2102005	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat					6,765,705
		09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor			5,464,500
2102005	01	09120	600	9999999	Paga	4,650,000
2102005	01	09120	601	9999999	Sigurime shoqerore	814,500
		09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm			641,850
2102005	01	09230	600	9999999	Paga	550,000
2102005	01	09230	601	9999999	Sigurime shoqerore	91,850
		10430	Përkujdesja Sociale			659,355
2102005	01	10430	600	9999999	Paga	565,000
2102005	01	10430	601	9999999	Sigurime shoqerore	94,355
2102022	Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve , Ujërave dhe Shërbimit Veterinar					1,160,000
		04240	Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit			750,000
2102022	01	04240	600	9999999	Paga	600,000
2102022	01	04240	601	9999999	Sigurime shoqerore	150,000
		04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave			410,000
2102022	01	04260	600	9999999	Paga	320,000
2102022	01	04260	601	9999999	Sigurime shoqerore	90,000
					Totali i Shtesave	17,533,008

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave , Agjencia e Shërbimeve Publike, Drejtoria Arsimore Bashkia Berat, Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve , Ujërave dhe Shërbimit Veterinar.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ervin CECA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr _____ prot

Berat më ____ / ____ / 2023

Lënda : Dërgohet material për shqyrtim e miratim

Z. Ervin Ceca

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projektvendimin dhe relacionin shoqërues për;“ PËR HEQJEN E PËRKOHSHME TË DEPOZITAVE TË UJIT NGA PALLATET E BANIMIT DHE HEQJEN E MENJËHERSHME NGA OBJEKTET E DËMTUARA QË PARAQESIN RREZIK PËR JETËN DHE SHËNDETIN E NJERËZVE”

KRYETARI

ERVIN DEMO

Konfirmoi : Petro Sinjari , Drejtor i Drejtorisë Juridike

Konceptoi : Luçiano Bojaxhiu , Drejtoria E Planifikimit Urban, Lejeve Dhe Monitorimit Të Investimeve

Datë _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT

PROJEKT-VENDIM

“PËR HEQJEN E PËRKOHSHME TË DEPOZITAVE TË UJIT NGA PALLATET E BANIMIT DHE HEQJEN E MENJËHERSHME NGA OBJEKTET E DËMTUARA QË PARAQESIN RREZIK PËR JETËN DHE SHËNDETIN E NJERËZVE”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 3, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 42, pika 1, shkronja “d”, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.10112, datë 9.4.2009, “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, vendimit nr.447, datë 16.06.2010, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, nenit 7.1, shkronja “d” dhe nenit 7.4, shkronja “a”, të vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, Këshilli Bashkiak Berat në mbledhjen e datës _____.____.2023

V E N D O S I :

- 1.** Marrjen e masave të menjëhershme për heqjen e depozitave të ujit nga tarracat e pallateve që nga akt konstatimet paraprake të Institutit të Ndërtimit apo grupet përkatëse të inspektimit, janë shpallur të pabanueshme apo banorët e tyre janë evakuar për shkak se godinat kërkojnë një rivlerësim të thelluar mbi gjendjen e tyre strukturore.
- 2.** Në të gjitha pallatet e banimit që nuk kanë pësuar dëme nga fatkeqësitë natyrore, si pasojë e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, me qëllim sigurinë e jetës dhe shëndetit, hiqen përkohësisht nga tarracat e përbashkëta të pallateve të banimit të gjitha depozitat e ujit deri në momentin që asamblatë e bashkëpronarëve dhe administratorët të jenë pajisur me raportin e hartuar nga ekspert i licencuar mbi qëndrueshmërinë konstruktive të tarracës dhe objekteve në bashkëpronësi.
- 3.** Depozitat e ujit të rivendosen pas hartimit të raportit të përgatitur nga ekspertë të licencuar në fushën e ndërtimit që vërteton se konstruksioni mbajtës i tarracës dhe i godinës në tërësi lejon vendosjen e tyre në tarracat e përbashkëta dhe vetëm pasi të jetë marrë pëlqimi i shumicës së asamblesë së bashkëpronarëve.

4. Asambletë e bashkëpronarëve dhe administratorët e pallateve të banimit të marrim masa për lokalizimin dhe vendosjen e depozitave të përbashkëtave të ujit në ambiente të përshtatshme dhe të izoluar. Administratori është përgjegjës për administrimin dhe sigurinë e depozitave të përbashkëta.

5. Drejtoria e Emergjencave Civile me mbështetjen e Policisë Bashkiake, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, , dhe shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Tiranë”, sha koordinon dhe merr të gjitha masat e nevojshme për heqjen e menjëhershme të depozitave të ujit nga objektet të dëmtuara si pasojë e tërmetit të datës 26 nëntor 2019 dhe që paraqesin rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve.

K R Y E T A R

I KËSHILLIT BASHKIAK

Ervin CECA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2023

“MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË BERAT, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO-LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN E Z BILBIL BAZAJ BANESA E TË CILIT ESHTË DËMTUAR NGA ZJARRI, NGA BUXHETI I BASHKISE DHE BUXHETI I VITIT 2023 NË MINISTRINË E MBROJTJES, PROGRAMI “ EMERGJENCAT CIVILE “

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr.8756, datë 26.03.2001 “ Për Emergjencat Civile “ i ndryshuar dhe VKM nr.329 date 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore “: me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Berat për mbështetje financiare të shtetasit Bilbil Bazaj për dëmtimin e banesës nga zjarri i rënë në datat 28.08.2023.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Berat.
3. T’i akordojë si ndihmë emergjente nga buxheti i Bashkise Berat, fondi i emergjencave civile i destinuar dhe i miratuar nga Keshilli i Bashkisë për vitin 2023, familjes së shtetasit
 - Bilbi Bazaj ne vleren 395,692(treqind e nëntëdhjetë e pese mije e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dy) leke.
4. Ndihma financiare për familjen e shtetasit Bilbil Bazaj përcaktohet sipas kriterëve të VKM nr. 329, datë 16.05.2012.
5. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për t’i ardhur në ndihmë familjes së shtetasit Bilbil Bazaj banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria Mbrojtjes Civile Pronave Transportit dhe Sherbimeve.

KRYETARI I KËSHILLIT
Ervin Ceca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKTVENDIM

Nr _____ Datë ____/____/2023

**MBI NGRITJEN E KOMSIONIT TË INTEGRIMIT EUROPIAN
”**

Këshilli Bashkiak Berat, sot në datën ____/____/2023, pasi u njoh me materialin “Mbi ngritjen e Komisionit të Integrimit European”, mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar si dhe të gjithë legjislacionit të miratuar nga Këshilli Bashkiak me propozim të Shoqatës për Autonomi Vendore ,

V E N D O S I :

- 1.Në Kreun II,Organizimi dhe Struktura e Keshillit Bashkiak,neni 31- Emërtimi i Komisione të Përhershme ;*të shtohet një pikë që përcakton ngritjen e Komisionit të Integrimit European.*
- 2.Të bëhen propozime për anëtarët e Komisionit të Integrimit European

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ervin CECA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKTVENDIM

Nr _____ Datë ____/____/2023

MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË SHTETIT TË MBROJTJES CIVILE

Këshilli Bashkiak Berat, sot në datën ____/____/2023, pasi u njoh me materialin “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit të mbrojtjes civile”, mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM nr 414 datë 08.07.2021“ Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, pika 3.1 gërmat b, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 115/2021 “Për Buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, shkresës së Ministrisë së Mbrojtjes nr 86/6 prot. datë 27.03.2023” Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2023” me propozim të Kryetarit të Bashkisë Berat,

V E N D O S I :

1. Të mirtatojë përdorimin e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit të mbrojtjes civile në shumën 798,489.00 lekë të detajuar si më poshtë :
 - Lagjja “ 28 Nëntori“ , Rajoni nr 2 me vlerë 269,275.00 lek me tvsh.
 - Lagjja “ Donika Kastrioti” , Rruga “Vangjel Zoto”, Rajoni nr 3 me vlerë 529,214.00 lek me tvsh.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve, Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, Drejtoria Juridike Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave .
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ervin CECA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKTVENDIM

Nr _____ Datë ____/____/2023

**MBI MIRATIMIN E FONDEVE PËR NDËRHYRJEN EMERGJENTE TË PROJEKTIT
”NDËRTIMI I SHPATULLAVE TË URES NË FSHATIN LAPARDHA”**

Këshilli Bashkiak Berat, sot në datën ____/____/2023, pasi u njoh me materialin “**Mbi Miratimin e Fondeve për Ndërhyrjen Emergjente të Projektit ”Ndërtimi i Shpatullave të Ures në Fshatin Lapardha”**”, mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr 45/2019 “ Për mbrojtjen civile” , VKM nr 414 datë 08.07.2021“ Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” , pika 3.1 gërmat b, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” , ligjin nr. 84/2022 “Për Buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, shkresës së Ministrisë së Mbrojtjes nr 86/6 prot., datë 27.03.2023” Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2023”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Berat,

V E N D O S I :

1. Të mirtatojë fondin për ndërhyrjen emergjente sipas projektit “Ndërtimi i shpatullave të urës në fshatin Lapardha” në shumën 9,365,037.72 lekë me TVSH.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve, Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, Drejtoria Juridike Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave .
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ervin CECA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKTVENDIM

Nr _____ Datë ____/____/2023

**MBI MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE TË MINISTRISË SË FINANCAVE DHE
EKONOMISË PËR BASHKËFINACIMIN E PROJEKTEVE TË BASHKISË BERAT ME
FINANCIM TË HUAJ**

(shtesë buxheti me fondin për shpenzime kapitale për pagesë TVSH të projekteve me financim të huaj)

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës _____._____.2023 , pasi u njoh me materialin “ Mbi miratimin e përdorimit të fondeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për bashkëfinancimin e projekteve të bashkisë Berat me financim të huaj” (shtesë buxheti me fondin për shpenzime kapitale për pagesë TVSH dhe bashkëfinancim projekte me financim të huaj), mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 40, pika 1, neni 41, pika c, 54, gërma “dh”, neni 64 gërma “c”, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (i ndryshuar) , neni 6, gërma “d”, neni 28, pika 5, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar , të ligjit nr. 84/2022 “Për Buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 19.01.2023 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”; shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 16500/1 datë 09.10.2023 “Transferim fondi për shpenzime kapitale”, Vendimin e Këshillit Bashkiak nr 100 datë 22.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Berat,

V E N D O S I :

1. Në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 100 datë 22.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2023 dhe PBA 2023-2025” i ndryshuar , të bëhet shtesa e buxhetit si më poshtë :
– Të shtohet buxheti i vitit 2023 me 1,839,947 lekë në shpenzime kapitale për pagesë TVSH dhe bashkëfinancim projekte me financim të huaj.

Detajimi i shtesës së buxhetit :

Shtesë:

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Llogaria	Kod Projekti	Pershkrimi	Shuma LEK
2102001		Bashkia Berat (Aparati)				1,839,947
		08220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore			117,894

2102001	01.1	08220	231		Fond MFE per pagesën e TVSH për projektin me financim të huaj " Culture Lands", projekt i financuar nga programi nderkufitar IPA CBC, Greqi-Shqiperi	117,894
		09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor			1,722,053
2102001	01.1	09120	231		Fond MFE për pagesën e TVSH për projektin me financim të huaj "Shërbime multifunkionale në sektorin e arsimit", të financuar nga BE nëpërmjet instrumentit BE për bashkitë	1,322,639
2102001	01.1	09120	231		Fond MFE për pagesën e TVSH për projektin me financim të huaj "Shërbime multifunkionale në sektorin e arsimit", të financuar nga BE nëpërmjet instrumentit BE për bashkitë	399,414
					Totali i Shtesave	1,839,947

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Integritit European dhe Projekteve , Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave .

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ervin CECA